



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni Pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-009
Prishtinë, më 26 janar 2015, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 26 JANAR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Jasmina Zhivković dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi, Sasha Milosavljević, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Xheladin Hoxha, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Fehmi Hyseni, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 21 janar 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 janar 2015

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 janar 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia e shtyu për mbledhjen e radhës caktimin e rendit të ditës për seancë plenare, ngase nuk kishte pika të mjaftueshme për këtë javë.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Procedimi i Programit legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2015

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan nënkryetarët e Kuvendit: Sabri Hamiti dhe Xhavit Halit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë:

Përfundim

1. Programi legjislativ i Qeverisë së Kosovës për vitin 2015 t'u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit.
2. Ngarkohen komisionet parlamentare që, mbi bazën e Programit legjislativ të Qeverisë së Kosovës për vitin 2015 dhe të propozimeve të veta t'i hartojnë planet e punës periodike dhe programin e punës së komisioneve për vitin 2015 deri më 2. 2. 2015.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale që, në bazë të Programit legjislativ të Qeverisë së Kosovës dhe planeve të punës së komisioneve parlamentare ta hartojë Propozim-programin e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2015 deri më 5 shkurt 2015, i cili me propozim të Kryesisë së Kuvendit i procedohet seancës plenare për miratim.

2. Procedimi i nismës qytetare për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me nismën e qytetare për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nxori këtë:

Përfundim

1. Kërkohet nga Qeveria e Kosovës që të paraqet mendim lidhur me nismën qytetare për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë në afatin prej një muaji nga dita e pranimi.
2. Kërkohet nga Qeveria e Kosovës që, në pajtim me nenin 20.2 të Ligjit për nismat legislative ta përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së së këtij projektligji në afatin prej një muaji nga dita e pranimi.

3. Procedimi i petitionit të qytetarëve të Komunës së Rahovecit për ndriçimin e fatit të Ukshin Hotit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me petitionin e qytetarëve të Komunës së Rahovecit për ndriçimin e fatit të Ukshin Hotit, nxori këtë:

Përfundim

Ngarkohet Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta shqyrtojë petitionin e qytetarëve të Rahovecit për ndriçimin e fatit të Ukshin Hotit dhe Kryesisë së Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime lidhur për këtë çështje.

4. Kërkesa e kryetares së ish-Grupit të Grave Deputete për vazhdimin e kontratës së asistentes së këtij grupi

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: Valdete Bajrami, Sabri Hamiti, Donika Kada-Bujupi dhe Ismet Beqiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve, e shtyu për mbledhjen e radhës vendimmarrjen lidhur me kërkesën e kryetares së ish-Grupit të Grave Deputete për vazhdimin e kontratës së asistentes së këtij grupi.

5. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtarë në Turqi

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në këtë përbërje: Muhamet Mustafa, Visar Ymeri, Raif Qela dhe Pal Leka, si dhe nga stafi mbështetës i komisionit, Armend Ademaj, në Turqi, prej datës 4-6 shkurt 2015.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, si dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa shpenzimet e dala për pjesëmarrje në aktivitetet e organizuara nga Parlamenti Evropian rimbursohen në afat prej tre (3) muajsh nga vetë organizatori.

6. Iniciimi i procedurës për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me iniciimin procedurës për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mori këtë:

Vendim

1. Të shpallet konkursi për zgjedhjen e tre (3) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës.

2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bazë të dispozitave të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ta shpallë konkursin për tre (3) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ë Kosovës.

7. Iniciimi i procedurës për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturore

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: Sabri Hamiti dhe Adem Grabovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve lidhur me kërkesën për iniciimin e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturore, nxori këtë:

Përfundim

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport që, në konsultim me Qeverinë e Kosovës, përkatësisht me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ta trajtojë kërkesën për propozimin e anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturore dhe Kryesisë së Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

8. Njoftimi i deputetëve Etem Arifi dhe Veton Berisha për t’iu bashkuar Grupit Parlamentar të LDK-së

Kryesia, në bazë të nenit 20, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, u njoftua nga deputetët Etem Arifi dhe Veton Berisha se prej datës 11 dhjetor 2014 i janë bashkangjitur Grupit Parlamentar të LDK-së.

9. Njoftimi i deputetit Shaip Muja për tërheqje nga Grupi Parlamentar PDK-PD-LB-PSHDK-PKK

Kryesia, në bazë të nenit 20, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, u njoftua nga deputeti Shqip Muja se prej datës 18 dhjetor 2014 është tërhequr Grupit Parlamentar PDK-PD-LB-PSHDK-PKK dhe se në të ardhmen do të veprojë si deputet i pavarur.

10. Njoftimi lidhur me listën e anëtarëve të Grupit të Miqësisë të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë me Kuvendin e Republikës së Kosovës

Kryesia u njoftua me shkresën e Ambasadës së Republikës së Maqedonisë në Prishtinë dërguar Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe me listën e anëtarëve të Grupit të Miqësisë të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë me Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Lidhur me krijimin e grupeve të miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kuvendeve të shteteve tjera diskutuan: Xhavit Halit, Sabri Hamiti dhe Myfera Shinik, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

11. Njoftimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur me funksionimin e kësaj agjencie

Kryesia, pasi u njoftua me shkresën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur me funksionimin e kësaj agjencie, nxori këtë:

Përfundim

Ngarkohet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri që ta shqyrtojë shkresën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Kryesisë së Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime lidhur për këtë çështje.

12. Njoftimi i Komisionit për Punë të Jashtme lidhur me mundësinë e propozimit për formimin e grupeve të miqësisë

Kryesia, pasi u njoftua me shkresën e Komisionit për Punë të Jashtme lidhur me mundësinë e propozimit për formimin e grupeve të miqësisë, nxori këtë:

Përfundim

1. Kërkohej nga deputetët dhe grupet parlamentare të Kuvendit që, në bazë të rregullave 4 dhe 5 të Rregullores për formimin e grupeve të miqësisë, të propozojnë krijimin e tyre ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kuvendeve të shteteve tjera.

2. Propozimet e deputetëve dhe të grupeve parlamentare t'i dërgohen Komisionit për Punë të Jashtme që t'i shqyrtojë propozimet e deputetëve dhe të grupeve parlamentare për krijimin e grupeve të miqësisë dhe Kryesisë së Kuvendit t'ia paraqesë propozim-vendimin për miratim.

Pikat shtesë:

1. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtarë në Strasburg të Francës

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve: Enver Hoxhaj, Teuta Sahatqija, Glauk Konjufca dhe Emilja Rexhepi, si dhe zyrtarët e Administratës së Kuvendit, Shaban Selimi dhe Tringa Lila, për të marrë pjesë në punimet e pjesës së parë të Sesionit të rregullt të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, që do të mbahet në Strasburg të Francës, prej datës 26-31 janar 2015.

2. Të gjitha shpenzimet e dala për realizimin e kësaj vizite zyrtare, si dhe tejkalimin në bazë të rezervimit për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Nënkryetari i Kuvendit Xhavit Haliti tha se caktimin e anëtarëve të delegacioneve të Kuvendit për vizita jashtë vendit duhet ta caktojë Kryesia e Kuvendit. Staf i Administratës së Kuvendit nuk mund të jetë pjesë e delegacionit parlamentar. Delegacionin e Kuvendit në vizita jashtë vendit mund ta mbështesë vetëm një (1) zyrtar i Administratës së Kuvendit dhe atë në cilësinë e përkthyesit, ose të logjistikës.

2. Kërkesa për aprovimin e pjesëmarrjes në aktivitetet e Asamblesë Parlamentare për procesin e bashkëpunimit në Evropën Juglindore

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilit janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve kërkesën për aprovimin e pjesëmarrjes në aktivitetet e Asamblesë Parlamentare për procesin e bashkëpunimit në Evropën Juglindore e shtyu për mbledhjen e Kryesisë së radhës.

Të ndryshme:

1. Kërkesa e Grupit Parlamentar të LDK-së për ndarjen e një zyre

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, kërkoi që Salla C-302 e këtij grupi të zgjerohet edhe me bashkëngjitjen e zyrës N-328 për nevojat dhe aktivitetet e deputetëve të këtij grupi.

Kryetari tha se e mbështet kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 13:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për çështje plenare dhe procedurale